



## TRAJNIMI FINANCA PËR BIZNESIN

<b>Datat:</b>	30 & 31 Maj 2019
<b>Kohëzgjatja:</b>	2 ditë, ditën e Enjte dhe ditën e Premte.
<b>Orari:</b>	Fillon në orën 9:30 deri 16:00.
<b>Numri i pjesëmarrësve:</b>	Min 12 - Max 16.
<b>Vendi:</b>	Tiranë.
<b>Pushimi i drekës:</b>	Një orë, rreth orës 12:30-13:30.
<b>Pushimet e kafesë:</b>	Dy pushimet do të zhvillohen rreth orës 10:30 dhe orës 14:30.
<b>Gjuha:</b>	Shqip.
<b>Telefonat celulare:</b>	Telefonat celularë duhet të jenë të mbyllur ose të heshtur gjatë trajnimit.
<b>Trajnues:</b>	Erald Pashaj

### Prezantimi i trajnimit:

***"Në ditët e sotme është domosdoshmëri në çdo biznes, për të kuptuar dhe njohur shifrat e biznesit, kontrolluar të ardhurat, shpenzimet dhe analizuar raportet financiare"***

Trajnimi Financa për Biznesin (*Business Finance Training Course*) është një nga trajnimet më të dobishme sot në mbarë botën. Sot askush nuk mund të jetë i suksesshëm nëse nuk është financiarisht i përgatitur dhe nëse nuk kupton aspektet financiare të biznesit. Njohuritë financiare mund t'ju duken të vështira dhe raportet të paqarta. Por, a është vërtetë kaq e vështirë? - Jo, nuk është, përkundrazi, është shumë më e thjeshtë sesa mendoni.

Duke përdorur njohuritë e fituara në këtë trajnim, ju do të jeni në gjendje të lexoni dhe kuptoni raportet financiare, t'i lidhni ato me biznesin tuaj të përditshëm duke përmirësuar rezultatet.

### **Rreth trajnimit.**

Programi është shumë interaktiv dhe shpjegon terminologjinë e financave, dokumentet kryesore financiare, organizimin e financave dhe konceptet kyçe financiare si të ardhurat dhe kostot, buxhetimin, etj.

Teoria është e kombinuar me shembuj praktikë, video dhe ushtrime.

Ky trajnim do të zhvillohet pa PC ose aplikacione të tjera.

### **Si do të ju ndihmojë ky kurs?**

Ky kurs do të rrisë njohuritë tuaja financiare dhe do t'ju njohë me mënyrën se si shifrat paraqesin punën tuaj të përditshme dhe sesi nëpërmjet tyre ju të përmirësoni rezultatet.

**Temat që do trajtohen:**

**Dita e 1<sup>-rë</sup>**

1. Hyrje;
2. Bazat e terminologjisë financiare;
3. Departamenti i financës dhe ndërveprimi me departamentet e tjerë;
4. Raportet kryesore financiare; (Pasqyra e të Ardhurave & Shpenzimeve, Bilanci, Fluksi Monetar.)
5. Kontrolli i brendshëm;

**Dita e 2<sup>-të</sup>**

1. Përsëritje;
2. Përfitueshmëria nga klientët; (A janë të gjithë klientët fitimprurës?)
3. Planifikimi financiar; (Buxhetimi)
4. Kontrolli analitik; (Për çdo departament)
5. Konkluzione dhe mbyllja.

**Investimi:**

- Na kontaktoni: [info@eppc.al](mailto:info@eppc.al)

**Të përfshira:**

- Të gjitha materialet didaktike gjatë trajnimit;
- Libërlidhjet;
- Mjetet personale të punës;
- Organizimi. (Salla, drekat, pushimet e kafesë, etj.)

**Konfirmimi:**

Ju lutem të na konfirmoni № e punonjësve që dëshironi të dërgoni në këtë trajnim?

[1. Emër - Mbiemër; 2. Pozicioni; 3. Vite/muaj pune.]

